




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.17, datë 31.07.2023



PËR
SAKTËSIMIN DHE RINOVIMIN E LEJES NR.8/2 PROT., DATË
3.5.2017 MIRATUAR ME VENDIMIN NR.3, DATË 25.4.2017 “PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM
HIDROENERGJETIK
SUBJEKTIT “KUARCI BLACE”

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Saktësimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik me nr.8/2 prot., datë 3.5.2017 miratuar me vendim nr. 3 datë 25.4.2017 nga Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin.
2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes nr.8/2 prot., datë 3.5.2017 miratuar me vendim nr. 3 datë 25.4.2017 nga Këshillit të Basenit Ujor Shkumbin për “Përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik” nëpërmjet HEC Miraka subjektit “Kuarci Blace” me



vendndodhje në përroin e Lugjeve dhe Mirakës Bashkia Librazhd Qarku Elbasan.

3. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Miraka

Vepra e marrjes 1

- $X = 519527$; $Y = 4561411$; $Z = 610.72$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare vjetore $Q_{mes} = 0.15$ m³/s
- Prurja llogaritëse $Q_{llog} = 0.16$ m³/s
- Prurja ekologjike $Q_{eko} = 0.06$ m³/s
- Sasia e ujit që jepet në përdorim $Q = 0.16$ m³/s

Vepra e marrjes 2

- $X = 519586$; $Y = 4561422$; $Z = 609.45$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare vjetore $Q_{mes} = 0.02$ m³/s
- Prurja llogaritëse $Q_{llog} = 0.04$ m³/s
- Prurja ekologjike $Q_{eko} = 0.07$ m³/s
- Sasia e ujit që jepet në përdorim $Q = 0.04$ m³/s

Godina e Centralit

- $X = 520823$; $Y = 4559946$; $Z = 205$ m.m.n.d. (KRGJSH)
- Vëllimi i rrjedhës së kthyer: 0.2 m³/s

4. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
5. Ky vendim hyn në fuqi mbas konfirmimit të instalimit të stacionit hidrologjik tek vepra e marrjes dhe të stacionit metrologjik pranë godinës së centralit
6. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SHKUMBIN

MAJLINDA PERRIU

